

VENDIM
Nr. 187, datë 6.3.2013

**PËR MIRATIMIN E VLERËS SË PRONËS PËR SECILIN QARK TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe në vijim të pikës 3 të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së pronës, sipas llojit të pasurisë së paluajtshme, për secilin qark të Republikës së Shqipërisë, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha